



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURES  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 464 Prot.

Tiranë, më 03.04 2018

**VENDIM Nr. 74, datë 20.03.2018**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4, datë 20.03.2018, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor "Kolonizimi dhe procese urbanizimi në Apolloni. Reflektim në rrethinat e saj" 2018*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike) drejtues Prof. Dr. Bashkim Lahi (IA), Universiteti Humboldt, Berlin, Instituti Arkeologjik Austriak si dhe Akademia e Shkencave në Austri me mbështetjen e Institutit Arkeologjik Gjerman, Departamenti Romë, paraqitur nga Instituti Arkeologjisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor "Kolonizimi dhe procese urbanizimi në Apolloni. Reflektim në rrethinat e saj" 2018*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike) drejtues Prof. Dr. Bashkim Lahi (IA), Universiteti Humboldt, Berlin, Instituti Arkeologjik Austriak si dhe Akademia e Shkencave në Austri me mbështetjen e Institutit Arkeologjik Gjerman, Departamenti Romë, paraqitur nga Instituti Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:

**Në Apolloni**

- Gërmimet kryesore do të zhvillohen në taracën lindore, sipër teatrit ku ka disa sondazhe dhe kontrole gjeoradarë, të realizuara më parë, të cilët kanë dhënë dëshmi mbi fazën më të hershme të vendbanimit (fundi i shek.VII/VI pr.Kr.)

**Në Babunjë**

- Gërmimet do të zhvillohen kryesisht në shpatin lindor të kodrës ku ka dëshmi të shumta (gjurmë të arkitekturës dhe gjetje të imta), që lidhen me jetën e

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)

vendbanimit. Përmes gjurmimeve do të sqarohet koha e lindjes së vendbanimit dhe rrethanat në të cilat ai lindi, urbanistikën e tij, karakterin e banesës si dhe natyrën dhe shkallën e zhvillimit ekonomik.

#### Në Gurëzëzë

- Organizimi i kontrolleve elektromagnetike dhe atyre gjeoradarë, të cilët do të shtrihen në gjithë territorin e vendbanimit, shoqëruar me rilevimin e zonës;
  - Sondazhe kryesisht në zonën e "akropolit" dhe në shpatin JP të vendbanimit mund të plotësojnë më tej tablonë e parë të nevojshme për të përcaktuar ecurinë e mëtejshme të gjurmimeve/gjurmimeve në këtë zonë.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2018.
  3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
  4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
  5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
  6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**

